


- 10 -

KESHILLI PAPNOR
I DREJTESISE DHE I PAQES

LUFTA KUNDER
KORRUPSIONIT



Nën kujdesin e

Arqipëshkvisë Shkoder - Pult,

Mars 2009

Perktheu

Edison Macaj

Redaktoi

Loreta Toma

Lektor

Luigj Mila

Fagosja dhe grafika

Luigj Mila

Ky liber botohet nga Komrsioni Dioqezan

"Drejtesi dhe Paqe", i Argipeshkvisë

Metropolitane Shkoder-Pult

Nen kujdesin e Shkelqesise se Tij, Imzot Angelo Massafra,

Arqipeshkev dhe President i Komisionit, mbeshtetur nga
organizata katolike "Renovabis", nepermjet programin "Star".

PARAQITJE

Kisha katolike, me dëshirën për të treguar rrugën e të mirës së vërtetë të njeriut dhe të shoqërisë, është gjithmonë e vëmendshme ndaj të gjitha atyre dukurive njerëzore, kulturore, fetare e shoqërore që zhvillohen. Ajo i shikon me shqetësim të madh ato dukuri që ndikojnë negativisht në bashkëjetesën njerëzore dhe përfaqësojnë një kërcënim të përnjëmendte ndaj të mirës së përbashkët si vlerë themelore drejt të cilës duhet të priret jeta shoqërore. Ndër dukuritë veçanërisht negative, njëra që del në pah në mënyrë vërtet shqetësuese është ajo e korrupsionit. Megjithëse ai ka ekzistuar gjithmonë në historinë e njerëzimit, vetëm në vetet e fundit "për të është bërë një ndërgjegjësim në nivel ndërkombëtar" (nr.2). Veç kësaj, duket se është duke u forcuar dhe, sidomos, është duke u përhapur së shumti në forma dhe modalitete gjithnjë e më të sofistikuara dhe realisht të dëmshme për të mirën e të gjithëve. Atëherë, i nxitur prej angazhimit tim si Ipushkëv dhe prej kujdesit baritor për persona më janë besuar, ua paraqes të gjithë njerëzve vullnetmirë përkthimin në Këshillit gjuhën shqipe të "Vërejtjes" të botuar prej Papnor të Drejtësisë dhe Paqes mbi "Luftën kundër korrupsionit". Kjo "Vërejtje" është fryt i Konferencës Ndërkombëtare të organizuar nga i njëjti Këshill Papnor në ditët 2-3 qershor 2006. Prandaj e bekoj nismën e Komisionit Dioqezan "Drejtësi dhe Paqe" të Dioqezës sonë të Shkodër-Pultit, në personin e Përgjegjësit, z. Luigj Mila, që ka vendosur ta përkthejë dhe ta botojë këtë Vërejtje. Për arsye të asaj që shpreha më lart, ky vendim më është dukur menjëherë veçanërisht domethënës dhe i përshtatshëm. Veç kësaj, ky libërth i vogël vendoset në vazhdimësi me angazhimin e Dioqezës sonë për të përhapur Doktrinën Shoqërore të Kishës, që ka qëllimin të paraqesë dhe ta bëjë të njohur mendimin e Kishës katolike mbi çështje të ndryshme të jetës publike dhe shoqërore. Korrupsioni është një problem i shoqërive njerëzore të çdo vendi dhe të çdo kohe. Pra, ai e prek nga brenda edhe shoqërinë tonë, atë në të cilën jetojmë konkretisht. Mund II të prekë marrëdhëniet tona me institucionet publike. Mund të prekë çdo lloj marre"dhënieje II në të cilin një person ka një farë forme pushteti mbi një person tjetër. Kjo ndodh sepse, duke qenë i plagosur prej mëkatit, njeriu i nënshtrohet korrupsionit, qoftë si subjekt aktiv, që mundohet të nxjerrë përfitim në mënyrë të paligjshme, qoftë si objekt pasiv, që pëson padrejtësinë e më të fugishmit, pa gjetur forcën për të reaguuar. Pasojat negative të korrupsionit në fushën e politikës janë veçanërisht të rënda. Ndër të tjera, Vërejtja vë në dukje se ai shkakton një ftohje progresive të shtetasve përballë politikës, me pasojë dobësimin e institucioneve" (nr.4). "Lufta kundër korrupsionit", titulli i këtij dokumenti, është një luftë që buron prej ndërgjegjes sonë si njerëz.

Ajo na kërkon të mos e ulim kokën përballë një dukurie që është një padrejtësi e qartë dhe që në fund të fundit peshon mbi shpatullat e më të varfërve dhe më të dobtëve. Ai duhet të përballohet me seriozitet, me guxim, jo në mënyrë individuale (sepse bëhet e vështirë të mos mbetemi viktima të tij...), por duke u munduar ta ndihmojmë njëri-tjetrin në mënyrë të ndërsjellë për të mos iu nënshtruar logjikave apo gjesteve të korrupsionit. Për sa i përket realitetit tonë shqiptar, këtë luftë na e kërkon, madje na e imponon Europa si njërin prej kushteve thelbësore për hyrjen tonë në Bashkësinë Europiane .Por edhe më shumë, dhe më thellë, arsyes. Dhe .si të krishterë e kërkohet edhe prej vetë fesë sonë, si përnjëmendësisë së saj. Papa Pali II , në një fjalim të njohur drejtuar Ipeshkvijvc të Filipineve (30 tetor 2003) u ka kujtuar të gjithëve se "zhdukja e korrupsionit kikkon mbështetjen e angazhuar të të gjithë shtetasve, përcaktimin e vendosur të autoriteteve dhe një ndërgjegje të fortë morale". U uroj të gjithëve një lexim të vëmendshëm e aq më shumë një angazhim konkret, në jetën e përditshme, për këtë "Luftë" të madhe. Jerni të vetëdijshëm do të mund të fitojmë, duke e mposhtur korrupsionin, vetëm nëse do të jemi të bashkuar dhe vendosmërisht të bindur se "praktika dhe kultura e korrupsionit duhet të zëvendësohen nga praktika dhe kultura e ligjshmërisë" (nr. 5). I sigurt se Zoti do ta mbështesë çdo përpjekje tonën për të mirën, ju bekoj në Emër të tij

† Angelo Massafra

Arqipeshkëv Metropolit i Shkodër-Pultit

President i Komisionit Dioqezan Drejtësi dhe Paqe

1. Nga data 2 deri me 3 gershor 2006 në Vatikan është mbajtur Konferenca Ndërkombëtare e organizuar nga Këshilli Papnor i Drejtësisë dhe Paqes mbi temën "Lufta kundër korrupsionit". marrë pjesë funksionarë të lartë të Organizmave ndërkombëtarë, studiues dhe intelektualë, ambasadorë pranë Selisë së Shenjtë, profesorë dhe ekspertë. Qëllimi i Konferencës, siç u shprehë dhe Kardinali Renato Raffaele Martinol , ishte të njëjtojë më mirë fenomenin e korrupsionit, për të saktësuar metodat më të mira për t'iu kundërvënë dhe për të sqaruar kontributin që Kisha mund të japë në këtë sipërmarrje. Referues të ndryshëm të njohur, studiues dhe ekspertë të fenomenit në fjalë, i kanë ndihmuar pjesëmarrësit për të pasur një panoramë të asaj korrupsionit dhe të punës që po bëhet për t'iu kundërvënë në nivel botëror (Antonio Maria Costa)² , në sektorin privat (François Vincke)³ , në atë publik (David Hall)⁴ , në shoqërinë civile (Jong-Sung You)⁵ , në vendet e pasura e në ato të varfra (Eva Joly)⁶, duke vënë në dukje ndikimin e fortë të këtij fenomeni në ndaj të varfërve të botës (Cobus de Swardt), dhe karakteristikat e një kulture korrupsioni (Paul Wolfowitz)⁸. Shkëlqësia e Tij, Imzot Giampaolo Crepoldi⁹ ka paraqitur linjat e doktrines shoqërore të Kishës në këtë fushë.

2. Fenomeni i korrupsionit ka ekzistuar gjithmon, megjithatë prej pak vitesh jemi bërë vetëdijshëm në nivel ndërkombëtar. Në fakt, numri më i madh i konventave kundër korrupsionit dhe planeve të veprimit hartuar nga Shtete të veçanta apo grupe Shtetesh, nga Organizma ndërkombëtarë në fushat e tregtisë ndërkombëtare, në disiplinën e transaksione ndërkombëtare dhe sidomos në fushën e financës, i përkasin 15 vjetëve së fundit. Kjo do të thotë se korrupsioni është bërë tashmë një fenomen që spikat, por edhe që po përhapet në nivel botëror një vlerësim nega tiv për të dhe po konsolidohet një vetëdije e re për ta luftuar atë. Për këtë qëllim, janë vënë në punë instrumente analize empirike dhe vlerësimi sasior mbi korrupsionin që na lejojnë të njohim më mirë vetë dinamikat e praktikave të paligjshme që lidhen me të për të parapërgatitur mjete të përshtatshme, jo vetëm të tipit juridik dhe masa zhdukëse, për të luftuar kunder këtyre fenomeneve. Ky ndryshim i fundit është prodhuar, veçanërisht, nga dy fakte të mëdha historike. I pari është rënia e mureve ideologjike pas vitit 1989, dhe i dyti është globalizimi i informacionit. Të dy këta procese kanë ndihmuar që të vënë përhere e më shumë në dritë korrupsionin dhe për tu vetëdijesuar siç duhet. Hapja e kufijve si rrjedhojë e procesit të globalizimit bëri të mundur që korrupsioni të eksportohetme lehtësi më të madhe se në të kaluarën, por ofron edhe mundësinë për ta luftuar më mirë, nëpërmjet një bashkëpunimi më të ngushtë dhe të bashkërenditurndërkombëtar

1. President i Keshillit Pannor te DrejtesisC dhe te Pages dhe i Keshillit Pannor të Baritores për Migrantët.
- 2 Drejtor Ekzekutiv, Zyra e Kombeve të Bashkuara kundër Drogës dhe Krimit (UNODC).
- 3 President, Komisioni Anti-Korrupsion i Dhomës së Tregtisë Ndërkombëtare (ICC)
- 4 Drejtor, Bashkimi Ndërkombëtar i Kërkimeve mbi Shërbimet Publike (PSIRU), Bussines School, Universiteti i Greenwich-it.
- 5 Kennedy School of Government, Universiteti i Harvardit.
- 6 Këshilltare e posaçme për luftën kundër korrupsionit dhe pastrimit të parave, Norvegji.
- 7 Drejtor i Programeve Globale, Transparency International.
- 8 President i Bankës Botërore.
- 9 Sekretar I Këshillit Papnor të Drejtësisë dhe të Paqes.

3. Korrupsioni është një fenomen që nuk njeh kufij politikë dhe gjeografikë. Është i pranishëm në vendet e pasura dhe në ato të varfëra. Thelbi i ekonomisë së korrupsionit është i vështirë për t'u përcaktuar në mënyrë të saktë, dhe, në fakt, mbi këtë pikë, të dhënat shpesh nuk përputhen. Megjithatë bëhet fjalë për të ardhura shumë të mëdha, që i hiqen ekonomisë, prodhimit dhe politikave sociale. Shpenzimet bien mbi qytetarët, në fakt korrupsioni paguhet duke hequr fondet nga përdorimi i tyre i ligjshëm. Korrupsioni përshkon të gjithë sektorët socialë: nuk mund t'i vishet vetëm vepruesve ekonomikë, as vetëm funksionarëve publikë. Edhe shoqëria civile nuk përjashtohet. Është një fenomen që i përket si Shteteve të veçanta ashtu edhe oganizmave ndërkombëtarë. Korrupsioni favorizohet nga mungesa e transparencës në financën ndërkombëtare, nga ekzistenca e parajsave fiskale dhe nga pabarazia e niveleve mes formave të luftës kundër korrupsionit, shpesh brenda rrethit të një Shteti të veçantë, dhe fushave të veprimit të aktorëve të korrupsionit, zakonisht mbi shtetërore dhe ndërkombëtare. Favorizohet edhe nga bashkëpunimi i pakët mes Shteteve në sektorin e luftës kundër korrupsionit, nga ndryshueshmëria e tepërt e normave në sisteme e ndryshme juridike, nga mungesa e ndjeshmërisë së organeve shtypit kundrejt fenomeneve korrupsionit disa zona botës dhe nga mungesa demokratike të kontrollit e te vende ndryshme. Pa praninë e një shtypi të ri sistemeve demokratike të kontrollit e të transparencës korrupsioni është me siguri më i lehtë të zhvillohet. Korrupsioni ngjall shumë shqetësim pasi është i lidhur edhe me trafikimin e lëndëve narkotike, me pastrimin e parave, me tregtinë e paligjshme të armëve dhe me forma të tjera kriminaliteti.

4. Nëse korrupsioni është një dëm i rëndë nga pikëpamja materiale dhe një kosto e stërmadhe për rritjen ekonomike, edhe më negative janë efektet mbi të mirat jomateriale, të lidhura më shumë me dimensionin cilësor dhe njerëzor të jetës shoqërore. Korrupsioni politik, siç na mëson Përmbledhja e doktrinës shoqërore të Kishës, "kompromenton funksionimin e duhur të shtetit, duke ndihmuar negativisht në raportin mes qeverisjes dhe të qeverisurve; përhap një mosbesim në rritje në krahasim me institucionet publike, duke shkaktuar një larmi të qytetarëve përballë politikës dhe përfaqesueve të saj, me dobësimin e vazhdueshëm të disa institucioneve (n.411). Jepet disa, nderlidhje shume te yarta dhe në menyre empirike te treguara, ndëmjet korrupsionit dhe mungesës së kulturës, ndermjet korrupsionit dhe limiteve të funksionimit të sistemit institucional, ndermjet korrupsionit

dhe treguesve të zhvillimit njerëzor, ndërmjet korrupsionit dhe padrejtesive shoqërore. Nuk bëhet fjalë vetëm për një proces që dobëson sistemin ekonomik: korrupsioni ndalon përparimin e njeriut dhe i bën shoqëritë më pak të drejta e më pak të hapura.

5. Kisha e konsideron korrupsionin një fakt shumë të rëndë deformimi të sistemit politik. Kështu eshënjon Metoda e doktrinës shoqërore të Kishës: "Korrupsioni thyen që në r një r ol in e i ns tituc ionev e përf aqësuese , pasi i përdor is terren shkëmbimi politik ndërmjet kërkesave të përkrahësve dhe rendimentit të yeverisësve. Në këtë mënyrë zgjedhjet politike favorizojnë objektivat e ngushta derisa zotërojnë mjetet për të ndikuar dhe ndaluar realizimin e të mirës së përbashkët të të gjithë qytetarve" (n. 411). Korrupsioni duhet mbajtur "mes çështjeve e më shumë vendos zhvillimin e varfërisë" (n. 447) dhe shpeshherë është i pranishëm edhe në brendësi të të njëjtave procese ndihme për vendet e varfra. Korrupsioni i heq të drejtën popujve për një të mirë të përbashkët e themelore, atë të ligjshmërisë: respektim i rregullave, funksionim korrekt i institucioneve ekonomike dhe politike, transparenca. Ajo e ligjshmërisë është një e mirë e përbashkët me qëllim universal. Kjo është, pra, një nga çelësat për zhvillimin, i cili lejon të stabilizojë raporte korrekte mes shoqërive, ekonomisë dhe politikës dhe përmban panoramën e plotë të besimit mbi të cilin parashtrahet aktiviteti ekonomik. Duke qenë një "e mirë e përbashkët", ajo, pra ligjshmëria, në mënyrë të përshtatshme pranohet nga të gjithë: të gjithë popujt e kanë këtë të drejtë. Mes gjërave që i duhen njeriut në të cilat është e pranishme edhe ajo vetë, është pikërisht ligjshmëria. Praktika dhe kultura e korrupsionit duhet të zkvendësohen nga praktika dhe kultura e ligjshmërie.

6. Për të tejkaluar korrupsionin është pozitiv kalimi i shoqërive autoritare në shoqëri demokratike, i shoqërive të mbyllura në shoqëri të hapura, i shoqërive vertikale në shoqëri horizontale, i shoqërive qendrore në shoqëri me pjesëmarrje. Por nuk është e garantuar që këto kalime të jenë në mënyrë automatike pozitive. Duhet treguar shumë kujdes që hapja drejt diçkaje të re të mos rrënojë fortësinë e bindjeve morale dhe që pluralizmi të mos ndalojë lidhjet e forta shoqërore. Në strukturën e shumë shoqërive të

avancuara fshihet një rrezik i fortë korrupsioni, kjo jo më pak në ngurtësinë e shumë shoqërive arkaike. Nga njëra anë mund të haset sesi korrupsioni favorizohet në shoqëritë shumë të strukturuar, të ngurta e të mbyllura, deri edhe autoritare si në brendësi ashtu edhe drejt së jashtmes, pasi në to është më pak e lehtë të njihet manifestimi i tij: të korruptuarit dhe korruptuesit, në mungesë të transparences dhe të një shteti të vërtetë e të drejtë, mund të qëndrojnë të fshehur e madje dhe të mbrojtur. Korrupsioni mund të gjenerojë sepse mund të mbështetet mbi një situatë të qëndrueshme. Nga ana tjetër, mund të vihet re me lehtësi se si edhe në shoqëritë shumë më fleksibël dhe të lëvizshme, me mjete të shpejta e institucione demokratike të hapura e të lira, fshihen reziqe. Pluralizmi i tepruar mund të minojë mirëkuptimin etik mes qytetarëve. Babeli i stileve të jetës mund të dobësojë gjykimin moral mbi korrupsionin. Humbja e kufijve të brendshëm dhe të jashtëm në këtë shoqëri mund të lehtësojë eksportimin e korrupsionit.

7. Për të shmangur këto reziqe, doktrina shoqërore e Kishës propozon konceptin "ekologji njerëzore" (Centesimus annus, 38), përshtatur edhe për të orientuar luftën ndaj korrupsionit. Prurjet e korrupsionit mund të jenë në mënyrë të përshtatshme të kuptueshme vetëm nëse vështrohen si fryt i çarjes në ekologjinë njerëzore. Nëse familja nuk është në gjendje të zhvillojë detyrën e vet edukative, nëse ligjet kundër të rrires së vërtetë të njeriut si ato kundër jetës, që joshin qytetarët rreth të mirës, nëse drejtësia vazhdon me ngadalësi të tepruar, nëse morali i bazës dobësohet nga shkelja toleruese, nëse kushtet jetësore janë në rënie, nëse shkolla nuk mirëpret e nuk emancipon, nuk është e mundur të garantohet "ekologjia njerëzore" mbi të cilën mungon rrënja, më pas dhe fenomeni i korrupsionit. Nuk mund të harrohet, në fakt që korrupsioni përfshin një bashkim relatash, bashkëpunimesh, errësim ndërgjegjesh, shantazhe e kërcënime, pakte jo të shkruara dhe bashkëfajësi që thirren në apel, përpara strukturave, prsonave dhe ndërgjegjeve të tyre morale. Takohen këtu, me rëndësinë e tyre të madhe, edukimi dhe formimi moral i qytetarëve dhe detyra e kishës, e pranishme me bashkësitë e saj, institucionet, lëvizjet e shoqatat e besimtarëve individë në të gjitha lakimet e shoqërive të sotme, rruad të zhvillojë një rol gjithnjë e më të dukshëm në parandalimin e korrupsionit. Kisha mund të kultivojë dhe të promovojë burimet morale që ndihmojnë për të ndërtuar një "ekologji njerëzore" në të cilën korrupsioni nuk gjen një habitat të përshtatshëm.

8. Doktrina shoqërore e kishës vë në punë në frontin e luftës ndaj korrupsionit të gjitha parimet e saj themeltare orientuese, që ajo paraqet si të dhëna sjelljeje vetjake e kolektive. Këto janë dinjiteti i personit njerëzor, e mira e përbashkët, solidariteti, subvencionimi, mundësia e ndihmesës për të varfrit, destinacioni universal i të mirave. Korrupsioni bën kontrast në mënyrë rrënjësore me të gjitha këto parime.

Ai instrumentalizon personin njerëzor duke e përdorur me përcmim për interesa egoiste. Ndalon arritjen e të mirës së përbashkët sepse kundërvë kriteret individuale, cinizmin egoist dhe interesin e jashtëligjshëm në njërën anë. Kundërshton solidaritetin, pasi prodhon padrejtësi dhe varfëri, dhe subvencionimin, sepse nuk respekton rolet e ndryshme shoqërore dhe institucionale, por pikërisht e korrupton. Shkon edhe kundër mundësisë së ndihmës për të varfrit duke ndaluar që burimet në drejtim të tyre të vijnë në mënyrë korrekte. Nefundikundërvihet destinacioni universal të të mirave, pasi edhe ai i ligjshmërisë, siç edhe e kemi parë, është një e mirë e njeriut përnjeriun, e destinuar për të gjithë. E gjithë doktrina shoqërore e Kishës propozon një vizion të lidhjeve shoqërore absolutisht kundërshtuese me praktikën e korrupsionit. Që nga këtu rrjedh graviteti i këtij fenomeni dhe vlerësimi krejtësisht përkeqësues që i jep Kisha. Që nga këtu rrjedh edhe burimi i madh që Kisha hedh në fushë kundër korrupsionit: tërësinë e doktrinës së saj shoqërore dhe punën e saj frymëzuese.

9. Lufta kundër korrupsionit kërkohet të shtohen si bindja, nëpërmjet mirëkuptimit nga të dhënat morale, si dhe vetëdija që me këtë luftë arrihen avantazhe të rëndësishme shoqërore. Është ky mësimi i Centesimus amms, "Nieriu shkon drejt së mirës, por është i aftë edhe për të keqen; mund të shfaqë interesin e tij të menjëhershëm, e, megjithatë, të mbesë i lidhur me të. Rregulli shoqëror do të jetë shumë më i qëndrueshëm kur të kihet parasysh ky fakt dhe nuk do të kundërshtojë interesin personal ndaj shoqërisë në tërësi, por do të kërkojë mbi të gjitha, mënyrat e bashkëpunimit të tyre frytdhënës" (n. 25). Bëhet fjalë për një kriter në të vërtetë shumë efikas. Ky na thotë të vërejmë sjelljet e vrullshme të njeriut, por edhe për ta stimuluar atë; për të menduar që lufta ndaj korrupsionit është një vlerë, por edhe një nevojë; që korrupsioni është një e keqe, por është edhe çmim; që rrefuzimi i korrupsionit është një e mirë, por edhe një avantazh; që braktisja e praktikave korruptive mund të gjenerojë zhvillim e mirëqenie; që sjelljet e

ndershme stimulohen ndërsa ato të pandershmet ndëshkohen. Është shumë e rëndësishme për luftën ndaj korrupsionit që përgjegjësitë ndaj fakteve të paligjshme të sillen në dritë, që fajtorët të ndëshkohen me forma të riparueshme sjelljeje shoqërisht të përgjigjshme. Është gjithashtu e rëndësishme që shtete apo grupet ekonomike të cilat punojnë me një kod etik që nuk toleron sjelljet korruptive, të vlerësohen.

10. Në planin ndërkombëtar lufta ndaj korrupsionit kërkon që të veprohet për të shtuar transparencën e transaksioneve ekonomike e financiare dhe për të harmonizuar apo për të formuar bashkarisht legjislacionin në fushën e vendeve të ndryshme. Aktualisht është e lehtë të fshehësh fondet që vijnë nga korrupsioni dhe nga qeveritë e korruptuara të cilat arrijnë lehtësisht të eksportojnë kapitale të mëdha me bashkëpunëtorë të shumtë. Duke qenë se krimi i organizuar nuk ka barriera duhet të shtohet bashkëpunimi ndërkombëtar mes qeverive, të paktën në nivel juridik dhe në materien e ekstradimit. Ratifikimin konventave kundër korrupsionit është shumë i rëndësishëm dhe është për t'u përgëzuar që vendet firmëtare të konventës së OKB-së po shtohen dita-ditës. Mbetet më pas të përballemi me problemin e aplikimit të vërtetë të konvencioneve, duke qenë se për motive politike ato nuk kanë hyrë në brendësi të shumë shteteve, qofshin këto edhe firmëtare. Duhet që edhe në nivel ndërkombëtar të gjendet një marrëveshje mbi procedimin e konfiskimit dhe rikuperimin e asaj që quhej e jashtëligjshme, ndërsa sot normat që rregullojnë këto procedura janë vetëm të brendshme në shtete individuale. Të shumtë janë ata që mbrojnë konstituimin e një autoriteti ndërkombëtar kundër korrupsionit, me aftësi autonome veprimi, edhe shtete, dhe në gjendje të saktësojë krimet në bashkëpunim me korrupsionit ndërkombëtar dhe t'i sanksionojë. Në këtë pikë mund të jetë i nevojshëm aplikimi i parimit të subvencionimit me nivele të ndryshme autoriteti në fushën e luftës kundër korrupsionit.

11. Nji, e veçantë duhet të mbahet ndaj vendeve të varfra. Ato duhen ndihmuar, siç tha dhe lart, atje ku shfaqen mungesa nivel legjislativ dhe nuk zotërojnë ende institucionet juridike për luftën ndaj korrupsionit. Një bashkëpunim i dyanshëm apo i shumanshëm në sektorine de jure - për përtëritimin e sistemit të burgut, përfundimin e kompetencave hetimore, pavarësinë strukturore të magistraturës ndaj qeverive - është shumë i

nevojshëm si numërim i plotë mes ndihmesave për zhvillimin. Korrupsioni në vendet në zhvillim e sipër shpeshherë shkaktohet nga shoqëri perëndimore, madje nga Organizata shtetërore ose ndërkombëtare, krejt tjetër është nisma e korrupsioneve oligarkike lokale. Vetëm me një sjellje koherente dhe të disiplinuar të vendeve të pasura, mund të jetë e mundur për qeveritë e vendeve të varfra përfundimi i besueshmërisë. Një rrugë e mirë dhe e vlerësueshme është promovimi, në ato vende me demokraci, me një shtyp të lirë dhe vigjilent dhe me një gjallërim të shoqërisë civile. Planet e studiuara vend për shitësin nga ana e organizmave shikimi mund të arrijnë rezultate të mira në këtë fushë. Kishat lokale janë fortësisht të impenjuara në një formim dhe civil ndërgjegje dhe në edukimin dhe qytetarët drejtuar demokracisë një të drejtën, përherë dhe shpesh Konferencat Ipushkvnore më shumë për të vendosur Kane ndërhyrë Kunder korrupsionit dhe për një tjetër bashkëjetesë Nen qeverinë dhe ligjin. Vetëm kishat lokale të kërkojnë më mirë të më organizojnë në aktivitete e luftës kundër korrupsionit.

RENATO RAFFAELE Kard.

MARTINO

President

† GIAMPAOLO CREPALDI

Sekretar

Qyteti i Vatikanit, 21 shtator 2006

Festa e Shën Mateut, Apostull

Dhe Ungjilltar